

5. 10. 2018
prens

C.nr.597/18

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, gjyqtari Burim Emërllahu, në çështjen juridike të paditësit [redacted], nga Ferizaji, rr [redacted], pn, të cilin e përfaqëson avokati [redacted] nga Ferizaji, Rr [redacted] nr [redacted] kundër të paditurës Komuna e Ferizajit-Drejtoria e Arsimit në Ferizaj, të cilën e përfaqëson [redacted] për shkak të mospagimit të shpërblimit jubilar dhe pagave përcjellse pas pensionimit, pas mbajtjes së shqyrtimit e kryesor me datë 17.09.2018 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit [redacted] nga Ferizaji, rr [redacted], pn dhe detyrohet e paditura Komuna e Ferizajit-Drejtoria e Arsimit në Ferizaj që Paditësit [redacted] t'ia paguaj shumat si vijon: në emër të pagave përcjellëse pas pensionimit shumën prej 1665.27 euro, kurse në emër të një page jubilarë shumën prej 555.09 euro, të gjitha këto me kamatë prej 8% në vit duke filluar nga dita e parashtrimit të padis deri në pagesën definitive.

II. Detyrohet e paditura Komuna e Ferizajit-Drejtoria e Arsimit në Ferizaj që Paditësit [redacted] në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ia paguaj shumat si vijon: për përfaqësim nga përfaqësuesi tij në një seancë gjyqësore shumën prej 135.20 euro, për hartimin e padis nga përfaqësuesi i tij 104 euro, për taksën gjyqësore për padi 30 euro.

A r s y e t i m

Paditësi [redacted], nga Ferizaji, me datën 22.06.2018, ka parashtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurës Komuna e Ferizajit-Drejtoria e Arsimit në Ferizaj, me bazë juridike: pagesa pagave përcjellse pas pensionimit dhe një page në emër të shpërblimit jubilar.

Përfaqësuesi i paditësit avokati [redacted] nga Ferizaji gjatës seancës ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia me përmbajtje si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore.

Nga përmbajtja e padis së paditësit rezulton se i njejt i padin e bazon në faktet e theksuar nga paditësi se ka qenë në mardhënje pune te e paditura ,nga viti 01.09.1977 në cilësin e mësimdhënësit,mirëpo e paditura me rastin e pensionimit nuk ka vepruar siq parashifet me dispozitat e kontratës kolektive,sepse nuk ia ka paguar shumat që paditësi i kërkon me kërkesëpadi.

Përfaqësuesi i të paditurës Komuna e Ferizajit [REDACTED] ka deklaruar:e paditura ,Komuna e Ferizajit ,e konteston në tërësi padin dhe kërkesëpadin e paditësit si të pabazuar Konform nenit 35 pika 8 dhe 9 e Kontratës Kolektive nr.24,e datës 18.04.2017 e nënshkruar në mes të MASHT-it në njëren anë dhe SBASHK-ut në anën tjetër është paraparë tekstualishtë mënyra e realizimit të shpërblimit jubilar dhe afati i realizimit të kësaj të drejte ,duke specifikuar se për qdo 10 vjet shpërblim për pagë bazë.Në bazë të listës së pagave konstatohet se paditësi për muajin shkurt 2018 ka realizuar pagën neto në shumën prej 555.09 euro ,për muajin mars shumën prej 555.09 euro dhe për muajin prill shumën prej 555.09 euro gjithsejt shumën prej 1,665.27 euro.Drejtoria e Arsimit e Komunës së Ferizajit nuk është nënshkruese e kontratës kolektive e as në kontratën e punës e lidhur në mes punëdhënësit dhe punëkryersit nuk është paraparë përfitimi i shpërblimit jubilar dhe përcjellse me rastin e shkurjes në pension ,nga kjo rezulton se punëdhënësi nuk ka hy në asnjë mardhënie detyrimore në raport me punëkryersin.Drejtoria e Arsimit të Komunës së Ferizajit për të lartëshënuaren ka nxjerrë vendim për përfundimin e mardhënjes së punës pas moshës së pensionimit me nr.1190 ,dt 29.05.2018 që ka të bëjë me të drejtë ne paga jubilarë dhe përcjellse.Me asnjë dispozitë ligjore të ligjit mbi arsimin para universitar ,Ligjit të Arsimit të Komunave të Republikës së Kosovës dhe Kontratës së Punës për mësimdhënës nuk është paraparë kompensimi i pagave jubilarë dhe përcjellse.Njëkohësishtë Drejtoria e arsimit si punëdhënës nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive ,gjë që nuk mund edhe të obligohet derisa nuk ka marrë obligime kontraktuale.

Me qëllim të vërtetimit sa më të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë qështje juridike civile ,gjatë shqyrtimit gjyqësorë janë administruar si provë :Kopja e librezës së punës me numër 62763 dhe numër të regjistrit 6008/75 ,kontrata e punës ,e datës 01.03.2015, nr.1006/54,vendimi ,i datës 06.06.2018 ,i lëshuar nga Departamenti i Pensioneve,vërtetimi nr.173,i datës 03.12.2010,i lëshuar nga Gjimnazi "Skenderbeu",në Kaçanik,vërtetimi nr.497/03,i datës 04.05.2018,i lëshuar nga SHML Agrobiznesit dhe Teknologjisë "Zenel Hajdini",vërtetimi nr.10159,i datës 02.12.2010 ,i lëshuar nga Shkolla "Kuvendi i Arbërit",në Ferizaj,vërtetimi nr.96 ,i

datës 20.11.1994 ,lista e pagave për mujin ,mars ,prill,maj të vitit 2018 ,si dhe njoftimi ,i datës 05.09.2018 ,vendimi për përfundimin e mardhënjes së punës pas moshës së pensionimit nr.1190 ,i datës 29.05.2018 ,i lëshuar nga Drejtoria e Arsimit në Ferizaj.

Pas vlerësimit të provave të administruara si dhe deklaratave të ndërgjygjësve dhe fakteve jo kontestuese në mes tyre ,në kuptim të dispozitës së nenit 8 të LPK-së ,gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

Me leximin e Kontratës së Punës për Mësimdhënës, nr.1006/54 ,e datës 01.03.2015 , e lidhur në mes të Drejtorisë së Arsimit në Ferizaj dhe paditësit [REDAKTUAR] gjykata ka vërtetuar se paditësi ishte në mardhënje pune te e paditura,në vendin e punës Mësimdhënës i lëndës së gjuhës frenge,në Shkollën e Mesme e Lartë e Agrobiznesit dhe Teknologjisë "Zenel Hajdini",në Ferizaj,Komuna Ferizaj.

Me leçimin e vendimi për përfundimin e mardhënjes së punës pas moshës së pensionimit nr.1190 ,i datës 29.05.2018 ,i lëshuar nga Drejtoria e Arsimit në Ferizaj gjykata ka konstatuar se me këtë vendim e paditura kishte vendosur që paditësit ti përfundoj mardhënja e punës me datë 01.05.2018 ,si mësimdhënës në Shkollën e Mesme të Agrobiznesit dhe Teknologjisë "Zenel Hajdini",në Ferizaj,Komuna Ferizaj ,për shkak të arritjes së moshës se pensionimit 65 vjeqare dhe me këtë vendim ishte paraparë se i përmenduri gëzon të drejtën e marrjes së tri pagave ,në vlerën e pagës bazë të pagës së fundit nga punëdhënësi dhe të drejtën për shpërblim jubilar sipas kriterëve përkatëse.

Me leximin e vërtetimit nr.i prot 497/03,i datës 04.05.2018 i lëshuar nga SHML e Agrobiznesit dhe Teknologjisë "Zenel Hajdani",gjykata ka vërtetuar se paditësi [REDAKTUAR] në shkollën në fjalë ka punuar edhe mësimdhënës i gjuhës shqipe nga data 01.09.2010 deri me datë 30.04.2018

Nga faktet jo kontestuese ndërmjet palëve,por edhe nga lista e pagave rezulton se lartësia e pagës mujore të paditësit ka qenë 555.09 euro .

Me leximin e listave të pagave për muajt mars ,prill,maj të vitit 2018 ,gjykata ka vërtetuar se paditësi [REDAKTUAR] ka përvojë pune 38 vite.

Kurse ndërmjet palëve nuk ishte kontestues fakti se paditura me rastin e pensionimit nuk ia ka paguar paditësit shumat pagesën e të cilave paditësi e kërkon me kërkesëpadi.

Me nenin 35 paragrafi 9,të Kontratës Kolektiven të Arsimit në Kosovë,e datës 18.04.2017 është paraparë :punëtorët që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit.Pagat përcjellse paguhen nga punëdhënësi i fundit dhe jo më larg se 30 ditë nga dita e pensionimit.

Me nenin 35 paragrafi 8,të Kontratës Kolektiven të Arsimit në Kosovë,e datës 18.04.2017 është paraparë Punëtorët në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i fundit për 30 vjetë të përvojës në punë në vlerë të një page bazë,kurse me paragrafin 8.6 të të njejtit nen është paraparë se shpërblimi jubilar paguhet me rastin e 7 marsit të çdo viti.

Kjo gjykatë duke u nisur nga dispozitat e nenin 35 paragrafi 8 dhe 9,të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, si dhe gjendjes faktike të shpjeguar më lartë ,ka ncjerrur përfundim se është e bazuar kërkespadija e paditësit dhe nga kjo arsye edhe e ka detyruar te paditurën që paditësit t'ia paguaj shumën si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi,sepse nga provat e administruara u vertetuar fakti se paditësi [REDAKTUAR],ka qenë në mardhënje pune te e paditura moshën e pensionimit e ka arritur me datë 01.05.2018,kurse te e paditura ka punuar deri me datë 30.04.2018 ,mirëpo e paditura nuk ia ka paguar paditësit shumën e mjeteve monetare si ne piken I te dispozitivit te ketij aktgjykimi edhe pse ka pasur obligim t'ua paguaj në bazë të nenit 35 paragrafi 8 dhe 9,të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë ,sepse ajo edhe ka qenë punëdhënësi i fundit i tij.

Gjykata ka vlerësuar edhe thënjet e përfëqësuesit të të paditurës kur ka theksuar, se me asnjë dispozitë ligjore të Ligjit,mbi Arsimin Para Universitar,Ligjit të Arsimit të Komunave të Republikës së Kosovës nuk është paraparë kompenzimi i pagave jubilarë dhe përcjellse,mirëpo kjo gjykatës konsideron se kontratat e nënshkruara në mes të palëve kanë bazën ligjore në Ligjin për Mardhënjet e Detyrimeve, dispozitat përkatëse të këtij ligji që e rregullojnë materien e qështjes së kontratës,kurse konform nenit 8 të Ligjit për Mardhënjeve të Detyrimeve Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njejtit.

Gjykata ka analizuar edhe thënjet e përfaqësuesi të të paditurës i cili ka theksuar se e paditura nuk është nënshkruese e kontratës kolektive ,mirëpo kjo gjykatë konsideron se Kontrata kolektive e nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës,gjegjësishtë MASHT vlen për të gjitha Komunat e Republikës së Kosovës,sepse Qeveria e Republikës së Kosovës është organ i cili ka kompetenca për tërë teritorin e Kosovës,pra ushtrimi i kompetencave nga Qeveria e Kosovës nuk është i kufizuar vetëm në vendin ku ky organ e ka selinë në Prishtinë,e që ky përfundim ncjerret nga vetë emërtimi i këtij organi i cili quhet Qeveria Republikës së

Kosovës, e jo Qeveria e ndonjë Komune të caktuar. Përveq kësaj me neni 21 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës është paraparë se Autoritetet e larta të administratës shtetërore Qeveria në tërësi, Kryeministri, Zëvendës Kryeministrit dhe ministrat janë autoritetet e larta të administratës shtetërore. Ata udhëheqin dhe mbikëqyrin administratën shtetërore në fushat e tyre përkatëse të përgjegjësisë. Kurse me nenin 22 të ligjit të sipër përmendur është paraparë se Organet e larta të administratës shtetërore ushtrojnë detyra tjera administrative në bazë të ligjit ose nëse ushtrimi i këtyre detyrave nga një organ i lartë i administratës shtetërore është më efikas dhe efektiv se delegimi i detyrave në një organ tjetër të administratës shtetërore.

Gjykata bazuar në dispozitën e nenit 452.1 të LPK-së ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, kurse sa i përket lartësis për shpenzimet për përfaqësim dhe hartimin e padis mori parasysh edhe tarifen e Odes së Avokatve të Kosovës, kurse sa i përket taksës gjyqësore për padi mori parasysh edhe dëshmin mbi pagesën e kësaj takse.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Më datë 17.09.2017

Gjyqtari
Burim Emërllahu

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nëpërmes të kësaj gjykate.



REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROŠEVAC

Më
Dana

